



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE.



Korçë, më 20.05.2024

RELACION SHPJEGUES.

Mbi Caktimin e Përfaqësuesit të Këshillit Bashkiak me Qëllim Ushtrimin e Kompetencave në Sistemin On-Line të Strehimit.

Drejtuar:Këshillit Bashkiak

Në zbatim të pikës 1 ,neni 14,i ligjit 22/2018” Për strehimin”i ndryshuar “*Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës on-line në portalin unik qeveritar e-Albania*”.

Të dhënat që gjenerohen nga kërkesat on-line bëhen pjesë e bazës së të dhënave në nivel kombëtar të krijuar nga ministria përgjegjëse për strehimin.

Procedura e mëtejshme , vazhdon on-line dhe kërkon përfaqësim për të ushtruar rolin që ka Këshilli Bashkiak në zbatimin e kompetencave ligjore në sistemin on-line të strehimit me qëllim zbatimin hap pas hapi të qeverisjes elektronike.

Gjithë veprimtaria për vlerësimin e nevojave për strehim bazohet në sistemin e strehimit online dhe nga zyra tashmë janë zbatuar të gjitha proceset që i përkasin kompetencave të saj, si:

- Rregjistrimin e kërkesave-aplikime on-line.
- Vlerësimi i aplikimeve.
- Plotësimi i dokumentacionit.
- Kalimi për pikëzim.

Më tej procedura vazhdon me rolet përkatëse për Komisionin e Strehimit,Kryetarin e Bashkisë (të cialt janë plotësuar) për të vazhduar më tej në kompetencat e Këshillit Bashkiak.

Kompetencat e Këshillit Bashkiak në sistemin e strehimit on-line janë pjesë e procesit dhe çojnë në finalizimin e procedurës “Miratimi i familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit social”per cdo aplikim i cili është aprovuar sipas listës së përfituesve që shfaqet në sistem.

Për sa më sipër kërkojmë të zgjidhni dhe të na komunikoni personin që do përfaqësojë rolin tuaj në ushtrimin e kompetencave ligjore në sistemin on-line të strehimit.

Administratori lokal do verë në dispozicion sistemin on-line,kodin VPN dhe çdo të dhënë tjetër që mund të nevojitet për të ushtruar rolin tuaj në sistemin e strehimit social nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.

DREJTORE

Mirela Balli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

BASHKIA KORÇE
NR 283 PROT
DATA 12/01/2024

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

Nr.....Prot.

Datë. 12,01,2023

Lënda : Mbi përfaqësimin në sistemin e strehimit të ngritur në portalin qeveritar e-Albania.

Drejtuar: **KËSHILLIT BASHKIAK**
Bashkia Korçë.

Në zbatim të pikës 1 ,neni 14,i ligjit 22/2018” Për strehimin”i ndryshuar “*Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës on-line në portalin unik qeveritar “e-Albania”.*

Të dhënat që gjenerohen nga kërkesat bëhen pjesë e bazës së të dhënave në nivel kombëtar të krijuar nga ministria përgjegjëse për strehimin..

Procedura e mëtejshme , vazhdon on-line dhe kërkon përfaqësim për rolin që ka Këshilli Bashkiak në marjen e vendimeve për çështje të strehimit social , miratimin e familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit social.

Për sa më sipër kërkojmë të zgjidhni dhe të na komunikoni personin që do përfaqësojë rolin tuaj në ushtrimin e kompetencave ligjore në sistemin on-line të strehimit me qëllim zbatimin hap pas hapi të qeverisjes elektronike.

KRYETARI I BASHKISË



u